



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
“HASAN PRISHTINA”
UNIVERSITY OF PRISHTINA

Rr. Xhorxh Bush, Ndërtesa e Rektoratit, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +381 38 244 183 • E-mail: rektorati@uni-pr.edu • www.uni-pr.edu

Nr. Prot.: 01438
Datë: 18/5/2018

Senati i Universitetit të Prishtinës në bazë të nenit 210-220 të Statutit, në mbledhjen e mbajtur me datë 10.05.2018, miratoi:

UDHËZUES PËR VLERËSIMIN E LËNDËVE NGA STUDENTËT DHE PËRDORIMIN E REZULTATEVE TË TYRE NË UNIVERSITETIN E PRISHTINËS "HASAN PRISHTINA"

Prishtinë: Maj 2018

Përmbajtja

1.	Standardet e vlerësimit	3
2.	Qëllimet e vlerësimit të lëndëve.....	3
3.	Përgjegjësitë.....	4
4.	Proceset e vlerësimit.....	5
5.	Publikimi i rezultateve të vlerësimit.....	6
6.	Masat pasuese	6
	a) Raporti i Vlerësimit.....	7
	b) Mbledhjet e shqyrtimit të performancës për vlerësim të brendshëm.....	7
	c) Rekrutimi i stafit të ri akademik	7
	d) Promovimi i stafit akademik	7
	e) Zhvillimi i Stafit Akademik (Zhvillimi i Personelit)	7
	f) Përsëritje e përformances së dobët.....	8
7.	Rishikimi i Udhëzimeve në vitin 2019.....	8

1. Standardet e vlerësimit

Ky dokument specifikon rregullat e përcaktuara nga misioni, politikat dhe strategjitë e Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina" (UP), që burojnë në mënyrë të veçantë nga Statuti i UP (neni 211, 212, 213). Ky dokument është plotësish në përputhje me Standardet dhe Udhëzimet për Sigurimin e Cilësisë në Hapësirën Evropiane të Arsimit të Lartë (ESG, 2015) dhe Rregulloren e Sigurimit të Cilësisë dhe Vlerësimit në UP.

UP kryen vlerësimin e lëndëve në mënyrë të standardizuar dhe transparente. Këto udhëzime qartë rregullojnë mbledhjen dhe përdorimin e të dhënave të fituara gjatë vlerësimit të lëndëve. Ato zbatohen për të gjithë stafin akademik (duke përfshirë ligjëruesit me kohë të pjesshme/ligjëruesit e jashtëm dhe asistentët mësimdhënës), pavarësish nga thirrja shkencore apo pozita e tyre.

Vlerësimi i lëndëve nga studentët ka rol të rëndësishëm në grupin e masave për sigurimin e cilësisë që të gjitha së bashku ndërtojnë një sistem të sigurimit të cilësisë brenda Universitetit.

Në veçanti, rezultatet e vlerësimit i ndihmojnë mësimdhënësit dhe njësitë akademike që të vetë përmirësohen në mënyrë të vazhdueshëm. Në rastet kur personeli akademik nuk ka aftësi ose vullnet për t'u përmirësuar, universiteti do të vendosë masa/sanksione, p.sh. caktimin e detyrave/aktivitetave të reja.

2. Qëllimet e vlerësimit të lëndëve

Vlerësimi i lëndëve synon të përmirësojë aktivitetet e mësimdhënies në Universitet, në veçanti duke siguruar:

- Instrument për mbledhjen e informatave për efektshmërinë e mësimdhënies së stafit akademik (feedback'u) dhe
- Instrument për mbledhje të informatave për planifikim të punës për: dekanët, pro-dekanët për mësim, udhëheqësit e departamenteve / programeve të studimit, dhe menaxhmentin e universitetit.

Vlerësimet e lëndëve janë një pjesë e rëndësishme e krijimit të një kulture gjithëpërfshirëse të sigurimit të cilësisë. Përgjigjet e studentëve për cilësinë e një lënde (udhëzimet në mësimdhënie, mjedisin mësimor, etj.) u japin mësimdhënësve një informacion të vlefshëm se si studentët e perceptojnë si mësimdhënësin dhe mësimdhënien e tij. Të dhënët që rezultojnë nga vlerësimi kanë për qëllim të ndihmojnë mësimdhënësit të përmirësojnë dhe të zhvillojnë më tej përbajtjen e tyre të lëndëve, aty ku është e nevojshme.

3. Përgjegjësitë

Kultura e përgjithshme e sigurimit të cilësisë do të thotë se të gjithë mësimdhënësit dhe menaxherët e universitetit e konsiderojnë veten përgjegjës për cilësinë dhe marrin pjesë në këtë proces në të gjitha segmentet brenda institucionit. Tabela në vijim paraqet aktorët (personat përgjegjës) e ndryshëm në këtë proces dhe përshkruan shpërndarjen e detyrave dhe përgjegjësive të tyre.

Palët e interesuara	Përgjegjësitë
Rektori	<ul style="list-style-type: none"> Siguron që sistemi i sigurimit të cilësisë është pjesë përbërëse e menaxhimit në UP. Kontribuon në gjetjen e zqidhjeve për mësimdhënësit që shfaqin performancë të ulët në mënyrë të përsëritur. Merr rol udhëheqës kur studentët raportojnë një shkelje të ligjit.
Prorektori për Zhvillim dhe Sigurimin e Cilësisë	<ul style="list-style-type: none"> Përgjegjës për sistemin e cilësisë (detyra menaxheriale , raportim, etj). Inicion rishikimin e udhëzimeve në vitin 2020. Siguron një formë të përgjithshme (shabllon) për raportet e vlerësimit. Bashkë-kryeson takimet për shqyrtimin e performancës së brendshme.
Komisioni Qendror për Sigurimin e Cilësisë	<ul style="list-style-type: none"> Rishikon pyetësorët, miraton udhëzimet, inicion fillimin e politikave, strategjite dhe planin përmirësimin e cilësisë në lidhje me rezultatet e vlerësimit.
Senati	Miraton udhëzimet
Zyra për Zhvillim Akademik (ZZHA)	<ul style="list-style-type: none"> Realizon vlerësimet, përpunon të dhëna, përcjell dhe publikon rezultatet. Sipas kërkesave të menaxhmentit harton raportet që lidhen me rezultatet e vlerësimit.
Dekanët	<ul style="list-style-type: none"> Analizojnë të dhënat e vlerësimit dhe shkruajnë reportin e vlerësimit për njësinë akademike përkatëse. Vendosin për shpalljen e 10% të rezultateve më të mira të vlerësimit në faqen e internetit të fakultetit. Mbajnë intervista me mësimdhënësit dhe dakordohen mbi planet e përmirësimit me 10% të rezultateve me të ulëta të vlerësimit (nëse rezultatet janë nën mesataren 3.0). Shpërndajnë reportin e vlerësimit në mes mësimdhënësve të fakultetit përkatës. Bashkë-udhëheqës në takime gjatë shqyrtimit të performancës të vlerësimit të brendshme.
Prodekanët për mësim	Mbështetin dekanin në përmbushjen e detyrave të tyre
Komisioni për studime	<ul style="list-style-type: none"> Merr rezultatet e vlerësimit të mësimdhënësve që

	aplikojnë për promovim nga ZZHA dhe shqyrtojnë rezultatet e vlerësimit gjatë këtij procesi.
Koordinatorët për cilësi	<ul style="list-style-type: none"> Koordinojnë aktivitetet me studentët dhe stafin akademik, në raport me informimin, grumbullimin dhe publikimin e rezultateve të vlerësimeve. Rapoartojnë tek prodekani për mësim.
Anëtarët e stafit akademik (mësimdhënësit)	<ul style="list-style-type: none"> Përgjegjësi për cilësinë (detyra akademike). Informojnë studentët rrith përdorimit të rezultateve të vlerësimit.
Studentët	<ul style="list-style-type: none"> Plotësojnë pyetësorët Informohen për vazhdimësinë e vlerësimeve nëpërmjet mësimdhënësve të tyre përmes dekanit.

*Mundësia e vlerësimit: 5=pajtohem plotësisht; 4=pajtohem; 3=mesatarë; 2=nuk pajtohem; 1=nuk pajtohem fare.

4. Proceset e vlerësimit

UP, tashmë ka në përdorim një grup pyetësorësh të cilët janë zhvilluar në kuadër të një projekti evropian, bazuar në praktikat më të mira ndërkombëtare. Në pyetësorët e tillë janë specifikuar shkallët e vlerësimit si dhe niveli i vlerësimit i cili konsiderohet pozitiv. Komisioni për Sigurimin e Cilësi rishikon pyetësorët çdo pesë vjet (si fillim rishikimi i ardhshëm në vitin 2020).

ZZHA, respektivisht njësia për vlerësim i realizon vlerësimet, përpunon të dhënat, përcjell rezultatet dhe sipas kërkesave të menaxhmentit përpilon raporte që lidhen me rezultatet e vlerësimit. Menaxhimi i të dhënave është plotësisht i digjitalizuar.

Studentët plotësojnë pyetësorët në fund të çdo semestri (janar, qershori). Mësimdhënësit duhet ti informojnë studentët për vlerësimin dhe se si ata kanë përdorur rezultatet e vlerësimit për të përmirësuar përbajtjen e lëndëve.

Aktualisht, në UP vlerësohen të gjitha lëndët e ofruara, dhe të gjithë mësimdhënësit përgjegjës për lenden përkatëse. Kjo mund të çojë në një situatë në të cilën (1) Shkalla (përqindja) e përgjigjeve mund të ulët kur studentët mbingarkohen me plotësimin e pyetësorëve ose (2) UP mbledh të dhëna, por i përdor ato vetëm pjesërisht. Me këtë rast, në vitin 2020, Prorektori për Zhvillim dhe Sigurim të Cilësisë në bashkëpunim me Komisionin për Cilësi duhet të rishikojë gjithë sistemin e vlerësimit dhe të përshtatë frekuencën e vlerësimeve nëse është e nevojshme¹. Për studentët, pjesëmarrja në vlerësimin e lëndëve duhet të jetë vullnetare.

¹ Zgjidhja e mundshme: Futja e një cikli trevjeçar, çdo vit, një e treta e fakulteteve të UP marrin vlerësim të plotë (100% të kurseve dhe mësimdhënësve). Ky ritëm do t'i lejonte fakultetet të punonin në përmirësimin e këtyre dy viteve në mes të vlerësimeve.

5. Publikimi i rezultateve të vlerësimit

Rezultatet do të jenë në dispozicion për:

- Secilin mësimdhënës të vlerësuar i cili/a merr rezultatet e tij /saj nga ZZHA-ja në mënyrë elektronike.
- Studentët marrin informacion rreth vlerësimit përmes raporteve të shprehura gojarisht nga Dekani dhe mësimdhënësit, duke përmendur reagimet nga grupet e mëparshme të studentëve dhe përmirësimet pasuese. ZZHA iu përkujton mësimdhënësve, nevojën për t'ju prezantuar studentëve e raportet në formë gojore. Është shumë e rëndësishme bashkëpunimi dhe përvoja e studentëve që vlerësimi të çojë në përmirësimin e cilësisë së vazhdueshme.
- Dekanët dhe Prodekanët marrin të gjitha rezultatet për fakultetin i/e tyre.
- Rektori dhe Prorektori marrin të gjitha rezultatet për Universitetin.
- Komisioni për Studime, merr rezultatet e tre viteve të fundit të anëtarëve të stafit i cili aplikon për promovim.
- Në vitin 2020 , Prorektori për Sigurim të Cilësisë duhet të vlerësojë nëse shefi i departamenteve/programeve studimore duhet të përfshihet në listën e atyre që gjithashtu marrin rezultatet e vlerësimit (rezultatet e programit përkatës të departamentit/studimit).

Një klauzolë standarde në e-mail me të dhënat e vlerësimit duhet të bëjë të qartë se rezultatet e vlerësimit janë të dhëna të ndjeshme dhe prandaj duhet të trajtohen në mënyrë konfidenciale.

Nëse më pak se 30% e studenteve ose më pak se pesë studentë kanë plotësuar pyetësorin, rezultatet duhet të shkojnë vetëm tek mësimdhënësi (për shkak të mungesës së vlefshmërisë statistikore).

Për të ndihmuar interpretimin e

rezultateve të vlerësimit, ZZHA ofron modelin për secilën pyetje për të gjitha lendet e fakultetit (benchmarking). 10 % e rezultateve me të mira të vlerësimit vihen në dispozicion të publikut të gjërë përmes faqes së internetit të fakultetit. 10% rezultateve më të mira përcaktohen si 10% i lëndëve të secilit fakultet me rezultate mesatare më të mirë gjatë vlerësimin e përgjithshëm (d.m.th pyetje nr. 9 e pyetësorit)².

6. Masat pasuese

Jo vetëm procesi i vlerësimit si i tillë , por përdorimi adekuat i rezultateve të vlerësimit do të çojë në përmirësimin e cilësisë. Masat pasuese (përcjellëse) i referohen ose mësimdhënësi të vetëm ose fakultetit, në rast nevoje.

² Pyetje: "Si e vlerësoni mësimdhënësin në përgjithësi? ".

Si pasojë, është e mundur që një person është i përfaqësuar më shumë se një herë në krye 10%.

a) Raporti i Vlerësimit

Çdo vit, secili fakultet përgatit një raport vlerësimi. Në këtë raport, fakulteti analizon rezultatet e vlerësimit të lendeve, ofron informata të masave të sigurimit të cilësisë, dhe rendit planet për të përmirësuar cilësinë. Prorektori për Zhvillim dhe Cilësi siguron një model raportimi (përafërsisht 2-3 faqe, pa pjesë narrative, duke synuar përmirësimin/masat përcjellëse). Raporti nuk përbën të dhëna të personalizuara (përjashtim: të dhënat publike si 10% e vlerësimit me të mirë) dhe duhet të dërgohen të të gjithë anëtarët e fakultetit.

b) Mbledhjet e shqyrimit të performancës për vlerësim të brendshëm

Pas pranimit të Raportit të Vlerësimit, Prorektori për Zhvillim dhe Cilësisë dhe Dekanët e fakulteteve përkatëse takohen në një mbledhje të veçantë për rishikimin e performancës së vlerësimit të brendshme. Vlerësimi i performancës: e dobët 1.0-2.99, mesatare 3.0-4.0; e shkëlqyeshme 4.1- 5.0. Synimi i UP është që brenda 5 viteve të para në 70% të lëndëve të ketë vlerësime me performancë të shkëlqyeshme. Ky takim do të mbahet çdo vit, pjesëmarrësit në takim janë: Prorektori për Sigurim të Cilësisë, Dekani, Prodekanët, Koordinator i Zhvillimit Akademik të njësisë akademike; dhe (nëse menaxhmenti i fakultetit është dakord) Shefi e departamenteve dhe udhëheqësi i programit studimor.

c) Rekrutimi i stafit të ri akademik

Kandidatëve me përvojë në mësimdhënie të mëparshme në arsimin e lartë iu kërkohet të paraqesin rezultatet e vlerësimit të lëndëve nga institucioni i arsimit të larte paraprak gjatë procesit të aplikimit të tyre. Anëtarët e rinj të stafit mësimdhënës janë të detyruar të marrin pjesë së paku në dy trajnime dyditore për mësimdhënie gjatë dy viteve të para të punësimit (programi on-boarding). Universiteti i ofron këto kurse falas.

d) Promovimi i stafit akademik

Rezultatet e vlerësimit të lëndëve janë pjesë e të gjitha procedurave të promovimit (promovimi në një gradë më të lartë akademike, promovimi në një pozitë të mbajtur, etj.). Në rregulloren përkatëse për promovimin e stafit akademik do të specifikohet niveli minimal i vlerësimit, i nevojshëm për promovim në gradën e caktuar. ZZHA ofron rezultatet e vlerësimit të tri viteve të fundit në Komisionin për Studime, përkatës.

e) Zhvillimi i Stafit Akademik (Zhvillimi i Personelit)

Rezultatet e vlerësimit janë pjesë thelbësore e të gjitha intervistave vlerësuese. Punonjësit dhe mbikëqyrësit e tyre mund të bien dakord mbi masat përmirësuese siç janë trajnimet pedagogjike ose këshillimi nga kolegët.

Kryetari i komisionit të studimeve duhet të bjerë dakord mbi planet e përmirësimit me ata mësimdhënës, lëndët e të cilëve kanë pasur 10% të rezultateve më të ulëta gjate procesit të vlerësimit. 10% rezultateve më të ulëta përcaktohen si 10% i lëndëve të secilit fakultet me rezultate mesatare më të ulët gjatë vlerësimit të përgjithshëm (d.m.th pyetja nr. 9 e pyetësorit).

f) Përsëritje e performances së dobët

Nëse mësimdhënësit bëjnë pjesë në grupin e atyre me 10% rezultateve me të ulëta në njësinë akademike dy herë në tre vjet, Pro-Rektori për Zhvillim dhe Cilësi i fton ata për një intervistë vlerësimi dhe propozohen masa përmirësuese respektivisht trajnime plotësuese për përmirësimin e mësimdhënies. Nëse mësimdhënësi nuk e përmbush këtë marrëveshje, ose nëse performanca e tij/saj nuk përmirësohet, Pro-Rektori për Zhvillim dhe Cilësi inicion takimin e tij/saj me Rektorin. Masat e mundshme pas takimit janë:

- Vërejtje me shkrim nga Dekani i njësisë akademike përkatëse,
- Në rast të mos përfilljes së vërejtjes, paraqitja e masës pranë Komisionit të Etikës,
- Varësish nga lloji i vërejtjes, do të iniciohet për ndalesa të mëditjeve nga pagina,
- Masa të tjera konform Rregullores për masat dhe procedurat disiplinore ndaj personelit akademik dhe Kodit të etikës.

7. Rishikimi i Udhëzimeve në vitin 2019

Ky udhëzues duhet të rivlerësohet në vitin 2019, pas dy viteve të para të zbatimit të tij. Siç mund të shihet nga lart, pikat e rëndësishme për rivlerësim:

- Ndryshimi nga vlerësimi i plotë (100% e kurseve) në një sistem rrrotullues (p.sh. vlerësimi i një të tretës (1/3) të lëndëve brenda fakultetit në vit, për një cikël prej tre vjetësh të vlerësohen të gjitha lëndët) - për të zvogëluar ngarkesën e punës dhe për të rritur pjesëmarrjen e studentëve.
- Rritja e grupit të marrësve të rezultateve të vlerësimit të lendeve drejtuesve të departamenteve / programeve të studimit.
- Rishikimi i pyetësorëve të vlerësimit të lendeve.

Këto udhëzime mbeten të vlefshme deri në marrjen e vendime të reja.



Aneks 1: PYETËSORI PËR STUDENTË TË NIVELIT TË STUDIMEVE BACHELOR DHE MASTER

Pyetësori në vijim është forma e rekomanuar për studentët e nivelit bachelor dhe master. Në rast nevoje mund të lejohen ndryshime me qëllim të përshtatjes së kërkesave të departamentit tuaj.

Qëllimi primar i këtij pyetësori është të mblidhen këndvështrimet e studentëve të nivelit Bachelor dhe master në Departamentin e (*shëno emrin e departamentit*) për të gjitha aspektet e përvojës së mësimdhënies dhe të mësimnxënies në këtë departament dhe në UP.

Çdo sugjerim i dhënë nga ju, studentët, me qëllim të përmirësimit të cilësisë, do të jetë i mirëseardhur.

Rezultatet e këtij pyetësori do të shërbejnë për t'u ndihmuar atyre që e përgatisin Raportin e Vetëvlerësimit në departamentin që i nënshtrohet Vlerësimit të Cilësisë.

Nëse keni ndonjë koment për formën ose përbajtjen e këtij pyetësori, ju lutem të na kontaktoni në Zyrën për Zhvillim Akademik në UP, në e-mail adresën zzha@uni-pr.edu

Plotësimi i këtij pyetësori është një rast i mirë që të na tregoni mendimin tuaj lidhur me edukimin që jeni duke e marrë, prandaj sa më reale të janë sugjerimet tuaja, aq më të mëdha janë mundësítë që ato të shfrytëzohen për planifikimin e ardhshëm të departamentit tuaj.

Pyetësori është plotësisht anonim, por nga ju kërkohet të shënoni departamentin/drejtimin e studimit dhe vitin e studimeve, të cilin e ndiqni momentalisht.

Fakulteti/Departamenti: _____

Dega/drejtimi i studimit: _____

Viti i studimit: _____

Gjinia: _____

**1. Ju lutem, jepeni vlerësimin tuaj lidhur me çështjet e paraqitura me poshtë
(Vendosni shenjën x në shtyllën që pasqyron mendimin tuaj për çështjen që vlerësohet)**

MËSIMDHËNIA DHE MËSIMNXËNIA	Nuk pajtohem fare	Pajtohem pjesërisht	Pajtohem	Pajtohem plotësisht	Nuk e di
Materialet e prezantuara gjatë ligjératave na jepen rregullisht					
Literatura e sugjeruar për lëndët na bëhet e ditur që në fillim të semestrit					
Përbajtja e lëndës (syllabusi) na shpërndahet me kohë					
Orari i konsultimeve me profesorë është i shpallur					
Orari i konsultimeve me profesorë respektohet					
Që në fillim të vitit jemi të njoftuar me mënyrën e vlerësimit për lëndën përkatëse					
Metodat e mësimdhënies janë bashkëkohore					
Sallat e mësimit janë të pajisura mirë me mjete audio-vizuale për konkretizimin e mësimit					
Raporti në mes pjesës teorike dhe laboratorike (praktike) të lëndëve është adekuat					
Studentit është i lirë që vetë të përcaktohet për lëndët zgjedhore					
Orari i mësimit shpalitet me kohë					
Orari i shpallur i mësimit respektohet nga mësimdhënësit					
Programi i studimit është aktual me zhvillimet në këtë disiplinë të studimit					
Programi i studimit është i krahasueshëm me programet e ngjashme në universitetet e tjera					
Vlera e ECTS-së për lëndë është e llogaritur sipas ngarkesës së studentit					
Puna praktike jashtë institucionit aplikohet me rregull					
Komunikimi i udhëheqësve të departamentit me studentë është në					

shkallën e duhur					
Mundësitë e punësimit pas përfundimit të studimeve janë të njoitura për studentë					
Mendimi im i përgjithshëm për këtë program të studimit është pozitiv					
Këtë program të studimit do t'ia sugjeroja edhe personave të tjera					

1. A keni ndonjë sugjerim se si mund të përmirësohet cilësia e studimit në këtë departament

2. Ju lutem, jepeni vlerësimin tuaj lidhur me konstatimet e paraqitura me poshtë (Vendosni shenjën x në shtyllën që pasqyron mendimin tuaj për çështjen që vlerësohet)

PUNA LABORATORIKE/PRAKTIKE	Nuk pajtohem fare	Pajtohem pjesërisht	Pajtohem	Pajtohem plotësisht	Nuk e di
Materiali për përgatitjen e punës laboratorike/praktike na jepet paraprakisht					
Puna laboratorike/praktike mbikëqyret vazhdimisht nga mësimdhënësi					
Puna laboratorike/praktike përfshihet në vlerësimin përfundimtar të lëndës					
Laboratorët dhe sallat janë të furnizuara me pajisje, mjete dhe substancë të nevojshme					
Angazhimi i personelit mbështetës për realizimin e punës në laborator/praktike është i kënaqshëm					

2. A keni ndonjë sugjerim për përmirësimin e pjesës laboratorike/praktike të mësimit në Departamentin tuaj

3. Paraqitini mendimet tuaja lidhur me shërbimet e mëposhtme - shtoni edhe shërbime të tjera nëse nuk figurojnë në listë .

(Vendosni shenjën x në shtyllën që pasqyron mendimin tuaj për çështjen që vlerësohet)

SHËRBIMET DHE INFRASTRUKTURA	Nuk pajtohem fare	Pajtohem pjesërisht	Pajtohem	Pajtohem plotësisht	Nuk e di
Dekanati është i hapur për vërejtjet, sugjerimet dhe kërkesat e studentëve					
Shefi i departamentit është në kontakt të vazhdueshëm me studentë					
Zyra për marrëdhënie me jashtë ofron informacione të bollshme për studentë					
Shërbimet e administratës së fakultetit (paraqitura e provimeve) janë të kënaqshme					
Shërbimet e administratës qendrore janë në dispozicion për studentë					
Sallat e mësimit dhe laboratorët ofrojnë kushte të nevojshme për mësim cilësor.					
Mirëmbajtja e hapësirave universitare (niveli i pastërtisë) është në nivelin e duhur					
Sallat e kompjuterëve janë në dispozicion të studentëve					
Departamenti ka bibliotekën me literaturë profesionale të bollshme					
Biblioteka universitare është e pajisur me libra dhe literaturë elektronike bashkëkohore					
Biblioteka universitare ofron shërbime cilësore për studentë					
Departamenti posedon salla të veçanta të leximit për studentë					
Shërbimet për studentët me aftësi të kufizuara në departament janë në shkallë të duhur.					
Studentët kanë qasje në shtypjen dhe fotokopjin e materialeve për lexim në departament					
Tabelat e shpalljeve për studentë përmbytjen e informacione të bollshme dhe të vazhdueshme					
Studentët kanë qendra për sport dhe rekreacion brenda hapësirës universitare					
Vendosja e studentëve në Qendrën e studentëve është e kënaqshme					

Ushqimi i ofruar në mensën e studentëve është cilësor					
Qendra për këshillim dhe zhvillim të karrierës(LINK) ofron këshillime të dobishme për studentë					
Personeli i njësisë për TI ofron shërbime të nevojshme					
Universiteti ofron përkujdesje shëndetësore për studentë					
Unioni i studentëve në nivel të fakultetit i adreson nevojat e studentëve					
Parlamenti i studentëve angazhohet për interesat e të gjithë studentëve në UP					

3. A keni ndonjë sugjerim se si mund të përmirësohet cilësia e shërbimeve dhe infrastruktura
në Universitet /Fakultet/ Departament

Koment shtesë

Ju faleminderit për pjesëmarrje!



UNIVERSITETI I PRISHTINËS “HASAN PRISHTINA”

Semestri _____ viti _____ Departamenti: _____

Fakulteti _____ Programi i studimit _____

PYETËSORI PËR VLERËSIMIN E LËNDËS

Duke synuar që procesi i mësimdhënies të përmirësohet vazhdimesht, Universiteti i Prishtinës e konsideron të rëndësishëm vlerësimin e studentit për lëndën në përgjithësi, si dhe për cilësinë e mësimdhënies dhe të mësimdhënësve në veçanti.

Vlerësimet e juaja janë kontribut i çmueshëm për ne.

Vlerësimet janë plotësisht konfidenciale dhe pyetësori garanton anonimitet të plotë.

Mësimdhënësit do të njoftohen për rezultatet e vlerësimit të lëndës pas përfundimit të afatit të provimit.

Pēr secilēn pyeje rumbullakoni 1,2,3,4 ose 5:
 (5 = pajtohem plotēsīst; 4 = pajtohem; 3 = nuk e di; 2 = nuk pajtohem; 1 = aspak nuk pajtohem)

		Pajtohem plotēsīst	Pajtohem	Nuk e di	Nuk pajtohem	Aspak nuk pajtohem
1	Sillabus i lēndēs ēshē prezantuar nē fillim tē semestrīt.	5	4	3	2	1
2	Mēsimdhēnēsi/ja ka qenē i regult dhe ka ardhur nē kohē.	5	4	3	2	1
3	Mēsimdhēnēsi/ja ka ardhur i pērgatitur nē mēsim.	5	4	3	2	1
4	Mēsimdhēnēsi/ja ka inkuraujar diskutime dhe aktivitete nē klasē.	5	4	3	2	1
5	Mēsimdhēnēsi/ja ka mbajt konsultime.	5	4	3	2	1
6	Materialet mēsimore kanē qenē tē dobishme pēr studim.	5	4	3	2	1
7	Vlerēsim i punēs sē studentēve ēshē bērē nē vazhdimēsi.	5	4	3	2	1
8	Lēnda ka qenē e suksesshme pēr profesionin tē ardhshēm.	5	4	3	2	1
9	Si e vlerēsoni mēsimdhēnēsin/en nē pērgjithēsi.	5	4	3	2	1
10	Si e vlerēsoni lēndēn nē pērgjithēsi.	5	4	3	2	1

Pyetjet e hapura:

A keni ndonjë koment a sugjerim shtesë?

Zyra për zhvillim akademik
038 224 780 / ext 130; email: zzha@uni-pr.edu